

VENDIM
Nr.310, datë 14.5.2004

**PËR PËRCAKTIMIN E PERSONALITETEVE TË TJERA TË LARTA SHTETËRORE, QË
DO TË RUHEN NGA GARDA E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË PAS LIRIMIT NGA
FUNKSIONI DHE PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.422, DATË 12.9.2002 TË
KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR RUAJTJEN DHE SHOQËRIMIN E
PERSONALITETEVE TË LARTA SHTETËRORE”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2 të neni 5 të ligjit nr.8869, datë 22.5.2003 “Për Gardën e Republikës së Shqipërisë”, me propozimin e Ministrit të Rendit Publik, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Zëvendëskryeministri ruhet dhe mbrohet nga Garda e Republikës së Shqipërisë edhe dy vjet të tjera pas lirimit nga funksioni.
 2. Pika 6 e vendimit nr.422, datë 12.9.2002 të Këshillit të Ministrave, shfuqizohet.
 3. Ngarkohen Ministri i Rendit Publik dhe komandanti i Gardës së Republikës të Shqipërisë për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano